

VENDIM
Nr. 431, datë 17.5.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në ndarjen "Ministria e Financave", emërtesa "Këshilli i Menaxhimit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës" shfuqizohet.

b) Pas ndarjes "Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara" shtohet ndarja "Kryeministria 'Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës'" dhe në ndarjen "Ministria e Kulturës" shtohet nëndarja "Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit" sipas përcaktimeve të paraqitura në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim.

3. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela

Institucioni Buxhetor	Emertesa e Bordit/Keshilli/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Shpërblim kryetari (Lekë)	Shpërblim anëtar (Lekë)
			Kryetari	Nr. i Anëtareve		
Ministria e Kulturës	Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit	9	1	4	5,000	5,000
Kryeministria	Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës	10	1	2	15,000	10,000

